

NË LOZANË TË ZVICRËS

Fillim i mbarë i Institutit Zviceran të Studimeve Shqiptare ISEAL

Në hapje pos personaliteteve të zvicerane, morën pjesë edhe ambasadorët nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, ndërsa të nesërmen u mbajt një simpozium shkencor me temë: «**INTEGRIMI I SHQIPTARËVE NË ZVICËR, me një qasje krahasuese me komunitete tjera**»

Reshet BEATI



Ambasadorët Mehmet Elezi, Ramadan Nazifi, dhe Naim Malaj në bisedë me Victor Ruffly, ish kryetar i Parlamentit Zviceran

Zvicër, pari përshëndeti, kryetari i Këshillit të Institutit Zviceran të Studimeve Shqiptare ISEAL Francis Cousin, diplomat, ish ambasador i Zvicrës në Shqipëri, pastaj vazhduan me përshëndetje Alexandra Clerc, përfaqësuese e Byrosë Federale të Migracionit; Magaly Hanselmann, delegatë kantonit Vaud për integrim të të huajve dhe parandalim të racizmit dhe Jean Christophe Burquin, këshilltar komunal i Lozanës. Ndërsa nga radhët e shqiptarëve përshëndetën, Ambasadori i Shqipërisë në Zvicër Mehmet Elezi, ambasadori i Kosovës në Zvicër Naim Malaj dhe ambasadori i Maqedonisë, Ramadan Nazifi.

SHQIPTARËT NUK JANË VETËM OBJEKT I STUDIMEVE POR EDHE STUDIUES

Njeri nga nismëtarët e themelimit të këtij instituti, Driton Kajtazi, drejtor Institutit Zviceran të Studimeve Shqiptare - ISEAL. Ai me këtë rast pos tjerash përmendi se: «ka kohë që shqiptarët e Zvicrës janë parë nga disa sikur ngarkesë e

këtij vendi. Sot shqiptarët nuk janë ngarkesa por peshë e këtij vendi. Me Institutin Zviceran të Studimeve Shqiptare - ISEAL, shqiptarët nuk janë vetëm objekt i studimeve por edhe studiues. Më tej shtoi se me ISEAL, ne nuk do të kënaqemi vetëm duke përshkruar dhe informuar, por edhe duke studiuar, prodhuar dhe vepruar në veçanti nëpërmes sektorit të huatimeve, sektorit të botimeve, sektorit të medias dhe të cilave një botim mbaj shqiptarët e Zvicrës - në gjuhën gjermane, frënge, italiane dhe shqipe si dhe një Forum Ekonomik.

Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare e ka bërë më të vështirën por tani imbetet të bëjë më të rëndësishmen. 11 anëtarët themelues të ISEAL-it, 12 anëtarët e Komitetit të nderit të shoqatës „Miqë e >ISEAL dhe më tepër se 130 personalitete, në mesin e të cilëve përgjegjësit e 20 shoqatave të shqiptarëve të Zvicrës që kanë themeluar këto shoqatë janë garantët e nismës dhe mbartësit. Në fund Driton M. Kajtazi përfundoi me të themën popullore shqipe:

«sa më i thellë të jetë lumi, më i qetë është».

Hapja artistike me rastin e promovimit të institutit e bëri: Ilir Bytyçi me kitare dhe Diellza Ismajli recitimi të poezisë së autores zvicerane Anne Perrier, ndërsa mbylljen Gjon Gurahumi me disa përkrahje muzikore të interpretuara me harmonikë.

ARSIMIMI E INTEGRIMI, TEMA TRAJTIMI NË SIMPOZIUM

Më 13 nëntor në simpozium që u mbajt në lokale të Institutit të Studimeve të Larta në Administratë Publike - IDHEAP-Lozanë, ku me kumtesa u paraqitën personalitete të jetës arsimore, kulturore, por edhe politike, në qendër të vëmendjes ishin tri tema: Formimi, Pjesëmarrja shoqërore dhe Ekonomia dhe jeta shoqërore. Ndërkohë që simpoziumi në debatim përmbylles trajtoi temën: «Integrim po, por si?»-ku edhe morën ndër pjesëmarrje personale publike zvicerane Zoë Këshilltar i Shtetit - Philippe Leuba (PLR), Shef i Departamentit të

THEMELUESIT E ISEAL-IT

Mësojmë se anëtarët themelues të këtij instituti janë: Barbara BURRI-SHARANI, psikologe, Magaly HANSELMANN, koordinatore e kantonit Vaud në fushën e integritimit të të huajve dhe parandalimit të racizmit, Prof. Dr. Doris JAKUREC, ish drejtore e Qendrës së Kërkimeve Letrare të Zvicrës Franceze, Daniel ABIMI, gazetar, Francis COUSIN, ish ambasador, Driton KAJTAZI, autor dhe nismëtar, Prof. Dr. Peter KNOEPEL, Profesor titullar i katedrës së politikave publike, afatgjatë e zhvillimore për IDHEAP-it, Dr. Régis MARCIN-VEYRON, mjek-poliklinik, M. Bruno MIGLIARINI, kuadër bankar, Victor RUFFY, geograf, ish kryetar i Parlamentit Zviceran, Prof. Dr. Basile SCHADER, profesor në SHLP në Cyrih.

Shoqata aA(ISEAL) e ka edhe një Komitet nderi me 12 anëtarë: Prof. Dr. Antonio DA CUNHA, Prof. Astrit LEKA, Znj. Barbara HAERING, Dr. Christian ZINDEL, Z. Georges CUENOT, Znj. Katherina WASHINGTON, Shkoll. e tij, Z. Mehmet ELEZI, Z. Rolf ALTHERR, Z. Ueli LEUBENBERGER, Z. Xhemal BERISHA dhe artistja e madhe Znj. Vajë ZELA.

Brendshëm të Kantonit Vaud, Zonja Alice Glauser (UDC-SVP) - Anëtare e Parlamentit Zviceran, Zonja Ada Maria (PS) - anëtare e Parlamentit Zviceran si dhe Z. Antonio Hodgers (PGJZ) - anëtar i Parlamentit Zviceran.

Në pjesën e parë të simpoziumit dominuan temat rreth çështjes së arsimimit të fëmijëve e të rinjve shqiptar si dhe tema e integritimit, ku me kumtesa u paraqitën njohës të kësaj fushe si nga radhët e zviceranëve ashtu edhe shqiptarëve.

Që në nisim Institutit Zviceran i Studimeve Shqiptare ISEAL pati një fillim të mbarë, jo vetëm nga fakti i temave shumë përmbajtëse e me interes për komunitetin tonë të madh në këtë vend, por edhe për mënyrën e institucioneve zvicerane për tu marrë me çështësimet kryesore me të cilat përballen shqiptarët në këtë vend.



Francis Cousin, President i Këshillit të Fondacionit ISEAL



Tema e shkolimit ishte në qendër të vëmendjes, ku morën pjesë edhe arsimtarë shqiptarë